



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 01/32

Datë: 03.06.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, me qëllim të përcaktimit të fushëveprimit, procesit të hartimit, si dhe rolit dhe përgjegjësitë e palëve të përfshira në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim (në vijim: SKZH). Si një dokument që paraqet prioritetet më të larta të Qeverisë së Kosovës, dhe i cili duhet të adresojë pengesat kryesore të rritjes ekonomike të Republikës së Kosovës nëpërmjet një numri të masave të politikave afatmesme me ndikim të lartë, bazuar në analizat ekzistuese dhe në përputhshmëri me Programin e Qeverisë, dokumente të tjera strategjike të Qeverisë dhe kërkesat e procesit të integritit evropian, në mbledhjen e mbajtur me 3 qershor 2015, mori:

**V E N D I M**

**Për Përgatitjen e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim**

1. Të hartohet Strategjia Kombëtare për Zhvillim (në vijim: SKZH).
2. Kryeministri udhëheq dhe mbikëqyr procesin e hartimit të SKZH-së.
3. SKZH përbëhet prej një numri të kufizuar të masave specifike dhe relevante me treguesit e nivelit të lartë të përzgjedhur për matjen e progresit drejt arritjes së qëllimit të SKZH-së dhe mbulon periudhën prej gjashtë (6) vitesh dhe mund t'i nënshtrohet ndryshimeve në kuadër të vlerësimeve dyvjeçare.
4. Zyra për Planifikim Strategjik, në kuadër të Zyrës së Kryeministrit (në vijim: ZPS), mbështetë Kryeministrin dhe i propozon Kryeministrit një kalendar të detajuar lidhur me këtë proces, duke përfshirë konsultimin me hisedarë të tjerë.
5. Kryeministri krijon katër Grupe Punuese tematike ndërinstucionale si në vijim për të shqyrtuar propozimet e theksuara më lartë, duke përfshirë mundësinë për të bërë ndryshime dhe për të ofruar alternativa të tjera:

**5.1. Grupi Punues 1 (Punësimi):**

5.1.1. Si bashkë-kryesues, një Këshilltar i Kryeministrit dhe një zyrtar nga ZPS;

5.1.2. Deri në dy përfaqësues nga Ministrinë e: Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë; Punës dhe Mirëqenies Sociale; Tregtisë dhe Industrisë; Shëndetësisë; Diasporës; Komuniteteve dhe Kthimit; dhe Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, të emëruar nga ministrat përkatës duke përfshirë këshilltar të ministrave, sekretar të përgjithshëm,

udhëheqës të Departamenteve për Koordinim të Politikave dhe Integrim Evropian, përfaqësues i Zyrës Ligjore-ZKM, përfaqësuesi i Sekretariatit Koordinues të Qeverisë (SKQ) - ZKM dhe zyrtarë nga sektorët përkatës;

- 5.1.3. Drejtuesit e: Agjencisë për Barazi Gjinore dhe Zyrës për Qeverisje të Mirë të Zyrës së Kryeministrit;
- 5.1.4. Deri në tre përfaqësues të pushtetit lokal të caktuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal në konsultim me Asociacionin e Komunave të Kosovës;
- 5.1.5. Dy përfaqësues nga Ministria e Integritimit Evropian, Departamenti i Asistencës zhvillimore dhe Departamenti i Kriteve Ekonomike dhe Tregut të Brendshëm;
- 5.1.6. Një përfaqësues i Ministrisë së Financave, analist i buxhetit për portfolion përkatës;
- 5.1.7. Përfaqësuesi nga Ministria e Administratës Publike;
- 5.1.8. Përfaqësues nga institucione të tjera do të ftohen sipas nevojës.

## 5.2. Grupi Punues 2 (Sundimi i Ligjit):

- 5.2.1. Si bashkë-kryesues, një Këshilltar i Kryeministrit dhe një zyrtar nga ZPS;
- 5.2.2. Deri në dy përfaqësues nga Ministrinë e: Drejtësisë; Tregtisë dhe Industrisë; Administratës Publike; dhe Punëve të Brendshme, të emëruar nga ministrat përkatës duke përfshirë këshilltar të ministrave, sekretar të përgjithshëm, udhëheqës të Departamenteve për Koordinim të Politikave dhe Integrim Evropian dhe zyrtarë nga sektorët përkatës;
- 5.2.3. Deri në tre përfaqësues të pushtetit lokal të caktuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal në konsultim me Asociacionin e Komunave të Kosovës;
- 5.2.4. Drejtori i Zyrës Ligjore të Zyrës së Kryeministrit;
- 5.2.5. Dy përfaqësues nga Ministria e Integritimit Evropian, Departamenti i Asistencës zhvillimore dhe Departamenti i Kriteve Politike;
- 5.2.6. Një përfaqësues i Ministrisë së Financave, analist i buxhetit për portfolion përkatës;
- 5.2.7. Një përfaqësues i Sekretariatit Koordinues i Qeverisë;
- 5.2.8. Agjencia Kundër Korrupsionit, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, Organi Shqyrtues i Prokurimit, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Këshilli Prokurorial i Kosovës, Zyra e Ombudspersonit, dhe Zyra e Auditorit të Përgjithshëm po ashtu ftohen të marrin pjesë, secila me nga një përfaqësues.
- 5.2.9. Përfaqësues nga institucione të tjera do të ftohen sipas nevojës.

## 5.3. Grupi Punues 3 (Aktiviteti Ekonomik):

- 5.3.1. Si bashkë-kryesues, një Këshilltar i Kryeministrit dhe një zyrtar nga ZPS;
- 5.3.2. Deri në dy përfaqësues nga Ministrinë e: Tregtisë dhe Industrisë; Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural; Zhvillimit Ekonomik; Diasporës; dhe Punëve të Jashtme, të emëruar nga ministrat përkatës duke përfshirë këshilltar të ministrave, sekretar të përgjithshëm, udhëheqës të Departamenteve për Koordinim të Politikave dhe Integrim Evropian, përfaqësuesi i Zyrës Ligjore-ZKM, përfaqësuesi nga SKQ/ZKM dhe zyrtarë nga sektorët përkatës;
- 5.3.3. Kryeshefi i Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë;
- 5.3.4. Deri në tre përfaqësues të pushtetit lokal të caktuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal në konsultim me Asociacionin e Komunave të Kosovës;
- 5.3.5. Dy përfaqësues nga Ministria e Integritimit Evropian, Departamenti i Asistencës zhvillimore dhe Departamenti i Kriteve Ekonomike dhe Tregut të Brendshëm;
- 5.3.6. Një përfaqësues i Ministrisë së Financave, analist i buxhetit për portfolion përkatës;
- 5.3.7. Agjencia Kosovare e Privatizimit dhe Komisioni i Konkurrencës janë të ftuara të marrin pjesë me nga një përfaqësues për secilin.
- 5.3.8. Përfaqësues nga institucione të tjera do të ftohen sipas nevojës.

#### 5.4. Grupi Punues 4 (Infrastruktura):

- 5.4.1. Si bashkë-kryesues, një Këshilltar i Kryeministrit dhe një zyrtar nga ZPS;
  - 5.4.2. Deri në dy përfaqësues nga Ministrinë e Infrastrukturës; Zhvillimit Ekonomik; Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor; dhe Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, të emëruar nga ministrat përkatës duke përfshirë këshilltar të ministrave, sekretar të përgjithshëm, udhëheqës të Departamenteve për Koordinim të Politikave dhe Integrim Evropian, përfaqësues i Zyrës Ligjore-ZKM, përfaqësuesi nga SKQ/ZKM dhe zyrtarë nga sektorët përkatës;
  - 5.4.3. Deri në tre përfaqësues të pushtetit lokal të caktuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal në konsultim me Asociacionin e Komunave të Kosovës;
  - 5.4.4. Dy përfaqësues nga Ministria e Integritimit Evropian, Departamenti i Asistencës zhvillimore dhe Departamenti i Politikave Sektoriale;
  - 5.4.5. Një përfaqësues i Ministrisë së Financave, analist i buxhetit për portfolion përkatës;
  - 5.4.6. Zyra e Rregullatorit të Energjisë, Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave; Zyra e Rregullatorit për Ujë dhe Mbeturina; Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, po ashtu janë të ftuar të marrin pjesë secili me nga një përfaqësues.
  - 5.4.7. Përfaqësues nga institucione të tjera do të ftohen sipas nevojës.
6. Institucionet e përcaktuara si anëtarë të Grupeve Punuese emërojnë përfaqësuesit e tyre brenda dhjetë (10) ditëve pune që nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi. Zyra për Planifikim Strategjik e Zyrës së Kryeministrit koordinon procesin e emërimit të anëtarëve të grupeve punuese.
  7. Në emër të Kryeministrit, ZPS mandatohet të thërras takimet e Grupeve Punuese Ndërinstitucionale. Institucionet e përfshira në procesin e hartimit dhe institucionet e tjera qeveritare janë të obliguara të ofrojnë mbështetje dhe kontributin përkatës për Zyrën për Planifikim Strategjik brenda afateve të përcaktuara.
  8. Bashkë-kryesuesit e Grupeve Punuese identifikojnë organizatat më të përfaqësuara të hisedarëve aktivitetet e të cilave ndërlidhen me temat e diskutuara dhe sigurohen që Grupet Punuese konsultohen me to.
  9. ZPS, gjatë tërë procesit, e informon dhe diskuton progresin në takimet e Grupit Drejtues për Planifikim Strategjik dhe në përfundim të tij përgatitë draftin e SKZH-së pas pranimit të komenteve apo vërejtjeve nga Grupet Punuese dhe këtë draft e paraqet në shqyrtim përfundimtar te Grupi Drejtues për Planifikim Strategjik.
  10. Pas shqyrtimit dhe marrjes së vërejtjeve dhe komenteve përfundimtare nga Grupi Drejtues për Planifikim Strategjik, Kryeministri e paraqet për konsultim të mëtutjeshëm me publikun para propozimit për miratim në Qeveri.
  11. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

#### Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 02/32

Datë: 03.06.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësive administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 3 qershor 2015, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Projektligji për Faljen e Borxheve Publike.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 03/32

Datë: 03.06.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 3 qershor 2015, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Rregullorja për Koordinimin e Asistencës së Donatorëve të Jashtëm në Republikën e Kosovës.
2. Obligohet Ministria e Integritimit Evropian dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e rregullores nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 04/32

Datë: 03.06.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 3 qershor 2015, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Politika e Qeverisë për Ujëra.
2. Obligohen të gjitha institucionet kompetente për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 05/32

Datë: 03.06.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësive administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 3 qershor 2015, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Strategjia për Përmirësimin e Planifikimit dhe Koordinimit të Politikave (Sistemi i Planifikimit të Integruar).
2. Obligohet Zyra e Kryeministrit, Ministria e Financave, Ministria e Integritimit Evropian dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Strategjisë nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 06/32

Datë: 03.06.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 4 paragrafi 2 i Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësive administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 3 qershor 2015, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet nisma e Ministrisë së Financave për lidhjen e Marrëveshjes Ndërkombëtare për negocimin e kredisë me institucionet ndërkombëtare financiare për projektin e Rehabilitimit të Hekurudhave të Republikës së Kosovës.
2. Përgjatë negocimit të kësaj marrëveshje, Ministria e Financave obligohet të procedoj konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe dispozitave tjera në fuqi.
3. Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 07/32

Datë: 03.06.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 4 paragrafi 2 i Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 3 qershor 2015, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet nisma e Ministrisë së Financave për lidhjen e Marrëveshjes Ndërkombëtare për Masat e Eficiencës në Energji për nivelin komunal.
2. Përgjatë negociimit të kësaj marrëveshje, Ministria e Financave obligohet të procedoj konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe dispozitave tjera në fuqi.
3. Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 08/32

Datë: 03.06.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 15 paragrafi 4 i Ligjit nr. 04/L-036 mbi Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 3 qershor 2015, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Plani Vjetor i Statistikave Zyrtare për vitin 2016.
2. Agjencia e Statistikave e Kosovës është e obliguar që pjesën e implikimeve financiare të këtij plani ta harmonizoj me Ligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016.
3. Obligohet Agjencia e Statistikave e Kosovës për zbatimin e Planit nga pika 1. e këtij vendimi në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 09/32

Datë: 03.06.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 11 dhe 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 3 qershor 2015, nxjerr këtë:

**V E N D I M - P Ë R F U N D I M T A R**

1. Aprovohet shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga ndërtimi i Autostradës R6 Prishtinë-Han i Elezit, Sektori C2, Zonat Kadastrale Babush i Serbeve, Cernillë, Mirash, Rahovicë, Papaz dhe Sazli Komuna Ferizaj, sipas tabelave bashkangjitura këtij vendimi.
2. Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH, i dërgon vendimin subjektit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e përcaktuara në pikën 1. të këtij vendimi.
3. Brenda 10 (dhjetë) ditëve të punës pas miratimit të këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH bënë shpalljen e vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë ditore me tirazh të madh në Kosovë.
4. Pjesë integrale e këtij vendimi është akti i vlerësimit i punuar nga Zyra për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme/Ministria e Financave dhe tabelat të bashkangjitura këtij vendimi në të cilat është përcaktuar shuma e kompensimit për ata pronarë apo zotërues interesi, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilëve i'u janë prekur nga procesi i shpronësimit.
5. Kundër këtij vendimi subjektet kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike në gjykatën kompetente, vetëm për kundërshtimin e shumës së kompensimit të përcaktuar në këtë vendim, subjekti kërkues, cilido person i cili është pronar ose zotërues i interesit, ne pronën e paluajtshme ose të drejtat pronësore të prekura nga ky vendim, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme e cila është objekt i vendimit përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat e bashkëngjitura të këtij vendimi.

6. Brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike pas dorëzimit të ankesës në gjykatën kompetente parashtruesi i ankesës duhet të sigurojë që 5 (pesë) kopje të ankesës të dorëzohen fizikisht në zyrën ligjore të Organit përkatës Shpronësues, nëse parashtruesi i ankesës nuk vepron në përputhje me këtë paragraf, gjykata e refuzon ankesën.
7. Brenda 2 (dy) viteve nga data e hyrjes në fuqi të vendimit, Departamenti i Shpronësimit në kuadër të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor do të paguajë plotësisht shumën e kompensimit të shpronësimit, të përcaktuar në këtë vendim.
8. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Isa MUSTAFA

---

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 10/32

Datë: 03.06.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 11 dhe 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 3 qershor 2015, nxjerr këtë:

**V E N D I M - P Ë R F U N D I M T A R**

1. Aprovohet shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga ndërtimi i Rrugës Nacionale N9 Prishtinë-Pejë, Zona Kadastrale Mleqan, Komuna Malishevë dhe Rruga Nacionale N2, Prishtinë-Mitrovicë, Segmenti Milloshevë-Vushtrri Zona Kadastrale Milloshevë, Komuna Obiliq dhe Stanovc i Poshtëm, Komuna Vushtrri, sipas tabelave bashkangjitura këtij vendimi.
2. Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH, i dërgon vendimin subjektit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e përcaktuara në pikën 1. të këtij vendimi.
3. Brenda 10 (dhjetë) ditëve të punës pas miratimit të këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH bënë shpalljen e vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë ditore me tirazh të madh në Kosovë.
4. Pjesë integrale e këtij vendimi është akti i vlerësimit dhe tabelat të bashkangjitura këtij vendimi në të cilat është përcaktuar shuma e kompensimit për ata pronarë apo zotërues interesi, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilëve i'u janë prekur nga procesi i shpronësimit.
5. Kundër këtij vendimi subjektet kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike në gjykatën kompetente, vetëm për kundërshtimin e shumës së kompensimit të përcaktuar në këtë vendim, subjekti kërkues, cildo person i cili është pronar ose zotërues i interesit, ne pronën e paluajtshme ose të drejtat pronësore të prekura nga ky vendim, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme e cila është objekt i vendimit përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat e bashkëngjitura të këtij vendimi.

6. Brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike pas dorëzimit të ankesës në gjykatën kompetente parashtruesi i ankesës duhet të sigurojë që 5 (pesë) kopje të ankesës të dorëzohen fizikisht në zyrën ligjore të Organit përkatës Shpronësues, nëse parashtruesi i ankesës nuk vepron në përputhje me këtë paragraf, gjykata e refuzon ankesën.
7. Brenda 2 (dy) viteve nga data e hyrjes në fuqi të vendimit, Departamenti i Shpronësimit në kuadër të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor do të paguajë plotësisht shumën e kompensimit të shpronësimit, të përcaktuar në këtë vendim.
8. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

**Isa MUSTAJA**

---

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 11/32

Datë: 03.06.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 3 qershor 2015, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet kërkesa e Këshillit Organizativ për ceremoninë e rivarrimit të eshtrave të heroit kombëtar Isa Boletini për ndarjen e mjeteve financiare në vlerë prej 50,000.00 (pesëdhjetë mijë) euro.
2. Mjetet financiare nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga Rezerva e Qeverisë, nënprogrami Shpenzimet e Paparashikuara me kod 131 dhe barten në Zyrën e Kryeministrit kodit 104-106 në kategorinë ekonomike mallra dhe shërbime.
3. Obligohet Ministria e Financave, Zyra e Kryeministrit dhe Këshilli Organizativ për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 12/32

Datë: 03.06.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 13 paragrafi 6. të Ligjit Nr. 05/L-001 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësive administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 3 qershor 2015, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet kërkesa e Komunës së Zveçanit për ndarjen e mjeteve financiare në vlerë prej 25,000.00 (njëzetepesë mijë) euro për mbulimin e shpenzimeve për financimin e projektit për rifunksionalizimin e pompave për furnizim me ujë të pijshëm në tre fshatra të Komunës së Zveçanit.
2. Mjetet financiare nga pika 1. i këtij vendimi ndahen nga nën programi Zyra për Komunitete me kod 156 në Zyrën e Kryeministrit me kod organizativ 104 nga kategoria ekonomike-subvencionet dhe barten në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Kodi Organizativ 213, Kodi i nën Programit 225 Uji dhe Hedhurinat, Kategoria Ekonomike subvencione dhe transfere.
3. Obligohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik të raportoj në Zyrën për Çështje të Komuniteteve në lidhje me realizimin e projektit.
4. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që vendimin t'ia procedojë Kuvendit të Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
5. Obligohet Zyra e Kryeministrit, Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij Vendimi.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 13/32

Datë: 03.06.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 3 qershor 2015, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet kërkesa e Organizatës Joqeveritare Balkan Sunflowers për ndarjen e mjeteve financiare në vlerë prej 10,000.00 (dhjetë mijë) euro për mbulimin e shpenzimeve për zgjerimin e hapësirës për mësim për fëmijët e komunitetit Rom që jetojnë në Kosovë.
2. Mjetet financiare nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga buxheti i Zyrës për Çështje të Komuniteteve e Zyrës së Kryeministrit dhe barten në xhirollogarinë e OJQ Balkan Sunflowers në ProCredit Bank me numër të llogarisë 1117004414000155.
3. Obligohet Zyra e Kryeministrit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 14/32

Datë: 03.06.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 236 të Ligjit Nr. 04/L-149 për ekzekutimin e sanksioneve penale, Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores nr. 06/2010 për procedurat e emërimit në pozita të larta drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 3 qershor 2015, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Z. Bajram Bujupi, emërohet Drejtor i Përgjithshëm në Shërbimin Sprovues të Kosovës në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë.
2. Mandati i të emëruarit nga pika 1. e këtij vendimi zgjat pesë (5) vjet.
3. I emëruari nga pika 1. e këtij vendimi kryen të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me legjislacionin në fuqi.
4. Obligohet Ministria e Drejtësisë për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 15/32

Datë: 03.06.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, neni 73 të Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nenit 18 të Rregullores nr. 06/2012 për pozitat e larta drejtuese në shërbimin civil të Republikës së Kosovës duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësive administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 3 qershor 2015, mori:

**V E N D I M**

1. Themelohet Komisioni Disiplinor për Sekretaren e Përgjithshme në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë në këtë përbërje:
  - 1.1. Kujtim SHALA, Zëvendëskryeministër dhe Ministër i MKRS, Kryesues;
  - 1.2. Mahir YAGCILAR, Ministër i Administratës Publike, anëtar;
  - 1.3. Dalibor JEVTIC, Ministër për Komunitete dhe Kthim, anëtar;
  - 1.4. Fitim KRASNIQI, Sekretar i Përgjithshëm në ZKM anëtar dhe
  - 1.5. Besnik OSMANI, Sekretar i Përgjithshëm në MAPL, anëtar.
2. Komisioni Disiplinor nga pika 1. e këtij vendimi, kryen detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me Ligjin nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregulloren nr. 06/2012 për pozitat e larta drejtuese në shërbimin civil të Republikës së Kosovës dhe aktet tjera.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë